

Konsultimi i projekt akteve në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”-2016

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 janë hartuar këto projekt akte:

1. Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa së ligjin Nr.9640, datë 09.11.2006, “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, të ndryshuar;

Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9640, Datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, në datën 06.01.2016, në ambientet e MZHETTS u zhvillua një takim konsultues lidhur me ndryshimet e ligjit, ku në takim morën pjesë 3 përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë, Kryetarja e Bashkimit të Dhomave, Kryetari i Dhomës së Tiranës, përfaqësuesi i Dhomës së Tregtisë Shkodër dhe përfaqësues të Drejtorisë së Mbështetjes së Sipërmarrjes.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka organizuar disa takime konsultuese me Grupin e Punës në MZHETTS dhe palët e interesit të dokumentuar me procesverbalet përkatëse të këtij komisioni parlamentar.

Më datë 19.04.2016, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ishin të ftuar kryetarët respektivë të Dhomave të Tregtisë të Shkodrës, Durrësit dhe Fierit, përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, si edhe përfaqësues nga dhoma të huaja për të diskutuar mbi avantazhet dhe disavantazhet e këtyre dy modeleve mbi anëtarësimin e detyrueshëm, të dokumentuar me procesverbalin përkatës.

2. Ligji “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” është publikuar për konsultim në faqen e internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, link <http://kek.al/category/projekte/>.

3. Projekt-Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020 dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

Projekt-Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020 dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", të ndryshuar i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Njoftimi për konsultim publik është bërë me anë të e-mailit dhe në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave: www.dppm.gov.al, në rubrikën “Të reja”.